**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Gjilanit**
**Opština Gnjilane**
**Municipality of Gjilan**
Gilan Belediyesi

Duke u bazuar në nenin 26 paragrafi 1 dhe 27 paragrafi 1.4 të Rregullores për punën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, 01. nr.16-53246 të datës 13.06.2013, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 31.05.2016, miraton këtë:

# V E N D I M
## PËR PËRJASHTIMIN NGA MBLEDHJA TË ANËTARIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT, Z.SERGJAN MITROVIQ

1. PËRJASHTOHET nga seanca e pestë (V) e Kuvendit të Komunës s Gjilanit, e mbajtur më 31.03.2016, z.Sergjan Mitroviq anëtarë i Kuvendit të Komunës së Gjilanit nga radha e subjektit politik "Za Evropskom Pomoravlje".

2. Përjashtimi i z.Sergjan Mitroviq bëhet me kërkesë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit nga arësyeja se prezenca e tij në seancë po shkakton paknaqësi dhe rrëmujë në mjediset e Kuvendit, pasi që njëjti është emëruar nga Qeveria Sërbisë në pozitën e Ushtruesit të detyrës të Kryetarit të organit të përkohshëm i të ashtuquajturës Komunës së Gjilanit me seli në fshatin Kufc, si strukturë paralele e Qeverisë së Serbisë e instaluar në Komunën e Gjilanit.

3. Obligohen organet kompetente komunale që në bashkëpunim me Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme rreth rastit të z.Mitroviq .

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë.

.

01.Nr.__016-120/2016___
Gjilan, më 31.05.2016

Kuvendi i Komunës-Gjilan.

______________________
Valentina Bunjaku Rexhepi, Kryesuese